



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr 97 Datë 19 / 10 /2018

Mbi dhënien e Pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin Tetor 2018

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 7 dhe neni 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar; V.K.M nr. 618 datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar; Udhëzim nr. 366, datë 21.9.2017 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”; ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” Udhëzimin nr. 367 datë 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr 277 të Këshillit të Ministrave Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar ; Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, V.K.M nr. 31 datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar; Udhëzimin nr. 365 datë 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar ;V.K.M nr. 869 datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.Këshilli i Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin e pregatitur nga Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë

VENDOSI:

1. Përfitojnë **pagesë paaftësie** për muajin Tetor 2018 në total 527 persona me 6 739 466 lekë, të ndarë në:

- Të paaftë 261 persona me fond 2 844 760 lekë ne muaj
- Kujdestarë paaftësie 79 persona me nje fond 854 520 lekë në muaj
- Të verbër 111 persona me nje fond 1 490 746 lekë ne muaj

- Kujdestarë të verbër 26 persona me nje fond 317 200 lekë në muaj.
- Para e tetraplegjike 25 persona me një fond 668 750 lekë në muaj.
- Kujdestarë para e tetraplegjike 25 persona me një fond 282 250 lekë në muaj.
- Kompesim për energjinë elektrike 116 persona me fond 271 240 lekë ne muaj.
- Kompesim për telefon 10 persona me një fond 10 000 lekë në muaj.

2. Përfitojnë pagesë për shkak **Invaliditeti në punë** për muajin Tetor 2018 në total 346 persona me fond 1 068 800 lekë.

Vendimi u miratua me 13 vota pro, — vota abstenim, — vota kundër.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.



**KRYETARI I KËSHILLIT
PARTIZAN GORÇE**